



Nr. prot. 838, datë 08/03/2024

Nr. prot. 295, datë 06/03/2024

**MARRËVESHJE MIDIS UNIVERSITETIT BUJQËSOR TË TIRANËS  
DHE INSTITUTIT TË SHËNDETIT PUBLIK**

**Universiteti Bujqësor i Tiranës (më poshtë UBT) dhe Instituti i Shëndetit Publik (më poshtë ISHP)** me qëllim forcimin e bashkëpunimit mes dy institucione, bien dakord të bashkëpunojnë në fushat me interes reciprok. Kjo marrëveshje bazohet në nenin 3 të ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe neni 2 pika 6 e Statutit të UBT, VKM No 188, datë 13.3.2019, "Për ofrimin nga institucionet publike të arsimit të lartë të shërbimeve, në përputhje me veprimtarinë e tyre, për institucionet e qeverisjes qendrore dhe institucionet në varësi të tyre". Bashkëpunimi midis të dy institucioneve do të përfshijë :

## **NENI 1**

### **FUSHAT E BASHKËPUNIMIT**

Palët do të bashkëpunojnë në fushën e mëposhtme:

- Monitorimi i ndotjes mjedisore në industrinë e drurit.

## **NENI 2**

### **ROLI DHE PËRGJEGJËSITË**

1. UBT dhe ISHP do të bashkëpunojnë për identifikimin dhe implementimin e prioritetëve, ekspertizës, analizave laboratorike, transferimit të teknologjive dhe ofrimit të shërbimeve në fushën e lartpërmendur (Neni 1).

## **NENI 3**

### **KOHËZGJATJA**

1. Kohëzgjatja e kësaj marrëveshje është për 3 vjet dhe vlefshmëria e marrëveshjes fillon në datën e nënshkrimit të saj nga titullarët e të dy institucioneve. Afati i marrëveshjes mund të shtyhet nëse palët janë dakord për rinovimin e saj me shkrim.
2. Amendime mund të bëhen me marrëveshje nga Palët me shkrim, duke saktësuar datën e hyrjes në fuqi të tyre.

3. Në rastet e përfundimit të marrëveshjes nga njëra palë, duhet njoftuar me shkrim paraprakisht pala tjetër brenda një afati 2 mujor.

#### **NENI 4**

##### **ZBATIMI I MARRËVESHJES**

1. Palët bien dakort për përmbushjen reciproke të kushteve dhe detyrimeve që parashtrohen nga kjo marrëveshje bashkëpunimi.
2. Palët nënshkruese, duke marrë në konsideratë faktorë dhe probleme të reja që mund të dalin gjatë periudhës së mësipërme, me mirëkuptim të përbashkët, mund të ndryshojnë dhe plotësojnë marrëveshjen.

#### **NENI 5**

##### **PERSONAT E KONTAKTIT**

1. Secila nga palët përcakton një ose disa persona kontakti të cilës/it i drejtohen të gjitha komunikimet qofshin verbale apo të shkruara, si elektronike ashtu dhe të shtypura në letër.

#### **NENI 6**

##### **ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

Mosmarrëveshjet që mund të lindin mes palëve zgjidhen me frymën e mirëkuptimit dhe me bisedime ndërmjet tyre.

#### **NENI 7**

##### **DISPOZITA TË FUNDIT**

Palët janë të detyruara të respektojnë këtë marrëveshje për të gjithë kohëzgjatjen e parashikuar në nenin 4 të saj. Kjo marrëveshje nuk është burim i krijimit të detyrimeve monetare dhe financiare ndërmjet palëve.

Çdo palë merr përsipër të përbushë detyrimet sipas kësaj marrëveshje pa pretendim financiar ndaj palës tjetër.

Marrëveshja mund të ndryshohet vetëm nëpërmjet një dokumenti me shkrim të nënshkruar nga të dyja palët.

Kjo marrëveshje bashkëpunimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj nga palët dhe hartohet në 4 (katër) kopje të barazvleshme në gjuhën shqipe, nga 2 (dy) kopje për secilën palë.

**PËR**

**Universitetin Bujqësor të Tiranës**

**REKTORI**

**Prof. Dr. Fatbardh Sallaku**



**PËR**

**Institutin e Shëndetit Publik**

**DREJTORI**

**Prof.As. Eugena Tomini**

